



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE
Drejtoria e Administrimit te Prones Publike

URDHER

Nr. 268 Date 30.6.2003

PER

**ZMADHIMIN E KAPITALIT TE SH.A. "AGJENSIA DETARE SHTETETRORE
(TAULANTIA) " DURRES ME PERFSHIRJEN E REZERVAVE**

Drejtuar: Sh.a. "Agjensia Detare Shteterore (Taulantia) " Durres

Ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregetare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996 dhe Ligjin Nr. 8158, date 07.11.1996, Ligjit Nr. 8885 date 22.04.2002 dhe nenet 128, 150, te ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregetare", me cilesine e aksionerit te vetem ,


URDHEROJ:

Ne aktet e themelimit te Sh.A. "Agjensia Detare Shteterore (Taulantia) " Durres te behen ndryshimet e meposhteme:

1. Kapitali Themeltar te zmadhohet, **me perfshirjen e rezervave, per vleren 80.971.439 leke**, e barabarte me 80.971 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion.
2. Kapitali Themeltar i Sh.A. "Agjensia Detare Shteterore (Taulantia) " Durres, te behet 194.414.439 leke i barabarte me 194.414 aksione me vlere nominale 1000 leke per aksion.
Keto ndryshime te behen ne aktin e themelimit dhe ne statutin e shoqerise.
3. Ngarkohet Drejtoria e Administrimit te Prones Publike per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993 " Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare".
Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

Arben MALAJ

MINISTER



MINISTRISE SE EKONOMISE
Drejtore se Administrimit te Prones Publike Tirane

Sha "Agjensia Detare Shtetore Taulantia" Durres

Lenda: RAPORT I VECANTE i Ekspertes Kontabel te Autorizuar per ZMADHIMIN E KAPITALIT te Sha "Agjensia Detare shtetore Taulantia" Durres.

Ne zbatim te shkreses se Ministrise se Ekonomise Nr 4010 dt 22.05.2003 Lidhur me "Miratimin e Shperndarjen e rezultatit te vitit 2002 te Agjensise Detare Shtetore Taulantia Durres" dhe percaktimin e EKA per pergatitjen e raportit perkates per sistemimin (Zmadhimin) e kapitalit te shoqerise , si dhe ne zbatim te misionit te parashikuar nga neni 150 e 154 i ligjit 7638 dt 19.11.1992 "Per Shoqeri Tregtare" po ju paraqes raportin e vecante mbi Zmadhimin e kapitalit te shoqerise .

-Kam analizuar operacionin e Zmadhimit te kapitalit themeltar te shoqerise duke kryer verifikimet qe i kam cmuar te nevojshme sipas normave te profesionit si me poshte :

- a) Bazuar ne nenin 154(paragrafi i pare) te ligjit 7638 dt 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" kapitali nominal i nenshkruar i shoqerise perpara Zmadhimit te tij eshte shlyer plotesisht.
- b) Sha "Agjensia Detare Shtetore Taulantia" Durres eshte regjistruar si e tille me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr 26977 dt.5.03.1999.Bazuar ne nenin 154 (paragrafi I dyte) te ligjit 7638 dt 19.11.1992 ""Per Shoqeri Tregtare" duke qene nje shoqeri pa oferte publike dhe duke qene se ka mbushur 2 vjet nga e themelimi i saj nukeshte i nevojshem verifikimi i aktiveve e pasiveve te saj si dhe te avantazheve te vecanta kur ka te tille nga EKA apo ekspertet per kontributet te caktuar si te tille me vendim gjyqi .



- c) Nuk kam verejtje lidhur me motivin e Zmadhimit te kapitalit te shoqerise duke I bashkuar atij elemente te tjere te kapitaleve te veta si rezervat ligjore, rezervat nga fitimet,rezerva te tjera statutore etj.
- d) Lidhur me modalitetin e Zmadhimit te kapitalit themeltar te shoqerise (neni 150) jam dakort qe teknikisht Zmadhimi i kapitalit themeltar te realizohet nepermjet emetimit te aksioneve te reja pa ndryshuar vleren nominale te tyre 1000leke /aksion ,si i tille i percaktuar dhe ne vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane per rregjistrimin e shoqerise si person juridik.

Bazuar ne shkresen Nr 4010 dt 22.05.2003 Zmadhimi i kapitalit do te realizohet me perfshirjen e rezervave ne vleren 80.971.439 leke e cila ne menyre analitike perbehet nga :

Rezerva ligjore	12.136.035 leke
Fitime te viteve te kaluara	54.413.717 leke
Fondi i shperblimit te punonjesve	349.502 leke
Rezerve zhvillim nga fitimi i vitit 2002	14.072.185 leke
SHUMA	80.971.439 leke

Me vleren e mesiperme do te zmadhohet kapitali i nenshkruar i shoqerise dhe situata pas ketij operacioni do te jete :



EMERTIMI	31.12.2002 (para operacionit)	ne Leke viti 2003 (pas operacionit)
A KAPITALET E VETA	215.522.718	215.522.718
I Kapital themeltar , rezervat	215.173.216	215.522.718
a) Kapitali i nenshkruar	113.443.000	194.414.439
b) Prime te lidhura me kapitalin	-----	-----
c) Diferenca nga rivlersimi	-----	-----
d) Rezervat -Rezervat ligjore	12.136.035	-----
e) Fitime apo humbje te mbartura	54.413.717	-----
f) Fitime apo humbje te ushtrimit	35.180.464	21.108.279
II Fonde te tjera te vetat (Nd.Shteti)	-----
b) Fondi i shperblimit sup te punonj	349.502	-----

Sic shihet ky lloj operacioni i Zmadhimit te kapitalit nuk sjell ndonje ndryshim te madhesis se aktivitet neto apo te kapitaleve te veta te shoqerise sepse nuk ka hyrje te kontributeve te reja , ka vetem nje levizje shumash te cilat zbriten nga perbersit e tjere te kapitaleve te veta dhe I shtohen kapitalit te nenshkruar (themeltar) te shoqerise. Si rezultat i veprimeve te mesiperme kapitali i nenshkruar i shoqerise nga vlera 113.443.000 leke behet 194.414.439 leke.

Ndryshimet e mesiperme do te pasqyrohen edhe ne llogaridhenien vjetore te shoqerise per vitin ushtrimor 2003


Tirane 06.06.2003

EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR

Luljeta HASHO (CIPI)



PASIVI	31.12.2002		viti 2003	
KAPITALET E VETA	215.522.718	leke	215.522.718	leke
Kapitali themeltar ,rezervat,fitime,	215.173.216...	leke	215.522.718	leke
Kapitali I nenshkruar	113.443.000	leke	194.414.439	leke
Prime te lidhura me kapitalin				
Diferenca nga rivleresimi			-----	
Rezervat ligjore	12.136.035	leke	-----	
Fitime ose humbje te mbartura	54.413.717	leke	-----	
Fitime ose humbje te ushtrimit	35.180.464	leke	21.108.279	leke
Fonde te tjera te vetat (nd.shtetror				
Fondi I shperblimit suple.te punon	349.502	leke	-----	
DETYRIME	77.807.525	leke	77.807.525	leke
Detyrime te kerkueshme >1 vit	-----		-----	
Detyrime te kerkueshme deri 1 vit	77.807.525	leke	77.807.525	leke
Furnitore per blerje e sherbime	76.531.162	leke	76.531.162	leke
Personeli	732.480	leke	732.480	leke
Sigurime shoqerore dhe te ngjash	543.883	leke	543.883	leke
LLOGARI TE TJERA	6.427.269	leke	6.427.269	leke
TOTALI I PASIVIT	299.757.512	leke	299.757.512	leke



Data 16.06.2011



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKES
 DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS PUBLIKE

URDHËR

Nr. 436 Datë 14.6.2011

PËR

SISTEMIMIN E KAPITALIT TE SILVA "AGJENSIA DETARE TAULANTIA" DURRËS

Drejtuar: SH.A "AGJENSIA DETARE TAULANTIA" DURRËS ✓

NË mbështetje te nenit 102 pika 4 te Kushtetutës te Republikës së Shqipërisë dhe ne baze te paragrafit te pare te nenit 2 te Ligjit Nr. 8237, date 01.09.1997 "Për disa ndryshime ne Ligjin Nr. 7926, date 20.04.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore ne shoqëri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr. 1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr. 8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr. 1631, date 01.11.1996, Ligjin Nr. 8885, date 22.04.2002, dhe Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", me cilësinë e aksionarit te vetëm te Sh.a "Agjensia Detare Taulantia" Durrës,

URDHEROJ:

1. Kapitali Themeltar te zmadhohet për vlerën 49 139 419 leke , i barabarte me 49 139,4 aksione me vlere nominale 1000 leke secila.
2. Kapitali Themeltar te zvogëlohet për vlerën 70 078 661 leke , i barabarte me 70 078,6 aksione me vlere nominale 1000 leke secila.
3. Kapitali Themeltar i shoqërisë nga 194 414 439 leke behet 173 475 000 leke, i barabarte me 173 475 aksione me vlere nominale 1000 leke secila.
4. Keto ndryshime te bëhen ne aktet e themelimit te shoqërisë.
5. Bazuuar ne Ligjin 9723, date 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit" ngarkohet Drejtoria e shoqërisë " Agjensia Detare Taulantia" Durrës për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse ne regjistër.

Ky Urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

MINISTRI

NASIP NAÇO

**Eksperte Kontabel Te regjistruar
Anita Pulaj**

RAPORT

**PER SISTEMIMIN E KAPITALIT
TE SHOQERISE "AGJENSIA DETARE TAULANTIA" SH.A.**

DURRES

Tirane me 08/09/2010

**RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR PER SISTEMIMIN E
KAPITALIT TE REGJISTRUAR**

**Drejtuar: Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes
Shoqerise "Agjensia Detare Taulantia" sh.a**

Me cilesine e Ekspertit Kontabel te regjistruar te caktuar me urdhrin nr.4267/1 date 12/07/2010, te Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes, per Pergatitjen e raportit per sistemimin e Kapitalit te regjistruar te shoqerise "Agjensia Detare Taulantia" sh.a Durres, per:

- Humbjen e vitit 2008
- Fitimin e vitit 2009
- Rezerva zhvillimi

Per kryerjen e angazhimit per zvogelimin e kapitalit, jam mbeshtetur ne:

Bazen ligjore :

- Ligji 9901, date 06.05.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare",
- Urdhrin nr.4267/1 date 12/07/2010 te Ministrise se Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes.
- Ligji nr.9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finaciare"

Dokumentacionin e shoqerise:

- Ekstraktin e rregjistrimit prane QKR-se, Aktin e themelimit, Statutin e shoqerise .
- Bilancet kontabel dhe pasqyrat financiare te viteve 2008, 2009 te audituara dhe te miratuara .

Pergjegjësia jone eshte te shprehim nje opinion mbi ndryshimin e zerit "Kapitali i regjistruar" pjese perberse ne grupin "kapitalet e veta" mbi permbushjen e angazhimit per zmadhimin e kapitalit te regjistruar me perfshirjen e humbjeve te vitit 2008 , rezervave zhvillimi dhe fitimit te vitit 2009 ne kapitalin e regjistruar.

Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte 194.414.439 leke. Aksioneri i shoqerise me vendimin nr.4267/1 date 12/07/2010 ka vendosur per sistemimin e kapitalit me :

- Humbjen e vitit 2008 ne shumen (70.078.661)leke
- Rezerva te tjera ne shumen..... 23.489.857 leke
- Fitimi I vitit 2009 ne shumen 25.649.562 leke

te kaloje ne :

Sistemimin e kapitalit ne shumen(20.939.242) leke

Kapitali i shoqerise "Agjensia Detare Taulantia" sh.a Durres zvogelohet per 25.649.562 leke (-70.078.661 leke+ 23.489.857 leke+ 20.939.242 leke)

Per efekt te rumbullakosjes se vleres se aksioneve per 197 leke te zvogelohet kapitali dhe te shtohet ne rezerva ligjore.

Ne total te veprimeve kapitali shoqerise zvogelohet per (20.939.242 +197) = 20.939.439 leke

Ne kontabilitetin e shoqerise vendimi i aksionerit per sistemimin e kapitalit do te pasqyrohet si me poshte ;

Per humbjen e vitit 2008 :

Debi : Kapitali i regjistruar ne shumen 70.078.661 leke

Kredi : Fitime e humbje te mbartura ne shumen 70.078.661 leke

Per zerin rezerva te tjera :

Debi :Rezerva te tjera per shumen 23.489.857 leke

Kredi : Kapitali i regjistruar per shumen 23.489.660 leke.

Rezerva ligjore per 197 leke (per efekt rumbullakosje te vleres se aksioneve)

Per fitimin e vitit 2009:

Debi :Fitimi i vitit financiar per shumen 25.649.562 leke

Kredi :Kapitali i regjistruar per shumen 25.649.562 leke.

Duke u mbeshtetur ne bilancet kontabel dhe ekstraktin e QKR-se Tirane, kapitali i regjistruar i shoqerise eshte 194.414.439 leke i barabarte me 194.414 aksione me vlere nominale 1.000 leke secila.

Efekti i ndryshimeve te kapitalit themeltar me perfshirjen e Humbjeve te mbartura, rezervave te tjera dhe fitimi i vitit 2009 ne kapitalin e regjistruar eshte si me poshte:

- Kapitali i regjistruar para ndryshimit **194.414.439 leke**
- Zvogelim i kapitalit te regjistruar **20.939.439 leke**
- Kapitali i regjistruar pas zvogelimit **173.475.000 leke**

Kapitali I shoqerise "Agjensia Detare Taulantia" sh.a Durres eshte 173.475.000 leke (njqindeshtatedhjetetremilion e katerqindeshtedhjetepese mije leke) e barabarte me 173.475 aksione me vlere nominale 1.000 leke secila.

Ky kapital zoterohet 100% nga Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes aksionere e vetme Shoqerise "Agjensia Detare Taulantia" sh.a

Sipas opinionit tone misioni i sistemimit te kapitalit eshte kryer ne perputhje me kuadrin ligjor dhe permbush te gjitha kerkesat ligjore per kete qellim.

Tirane me 08/09/2010

Eksperte Kontabel e Regjistruar
Anita Pulaj

Bulevardi "Gjergj Fishta", Kompleksi "Tirana 2000", kulla nr.4, ap.19
Tirane, nr. Kontakti 0692087743